

Nr. Prot: 00494/26Datë: 21.08.2026

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Shtimes dhe Flutura Academy, bëjmë:

THIRRJE PUBLIKE PËR REGJISTRIMIN E 60 NXËNËSVE PËR TRAJNIM NGA “FLUTURA ACADEMY”

Hapet Thirrja Publike për regjistrimin e 60 nxënësve të interesuar nga Komuna e Shtimes për trajnimin e grupeve të reja nga “Flutura Academy”.

Regjistrimet janë të hapura për programet:

- ◆ Inteligjencë Artificiale (12–18 vjeç)
- ◆ Arduino & Elektronikë Bazë (8–14 vjeç)
- ◆ Programim për Fëmijë (8–10 vjeç)
- ◆ Programim Bazik (11–14 vjeç)
- ◆ Programim i Avancuar – Zhvillues Softueri Junior (15–18 vjeç)
- ◆ Robotikë (8–11 vjeç)
- ◆ Dizajn Grafik Bazik (11–14 vjeç)
- ◆ Dizajn Grafik i Avancuar (15–18 vjeç)
- ◆ Marketing Digjital (15–18 vjeç)
- ◆ Gjuhë Angleze (8–18 vjeç)

Periodha e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është 9 muaj.

Kriteret e regjistrimit të nxënësve në Flutura Academy në Komunën e Shtimes:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 8-18 vjeç;
- Të jetë nxënës i regjistruar në njërin nga shkollat publike në Komunën e Shtimes;
- Të ketë rezultate të mira mësimi në shkollë, përzgjedhja apo renditja bëhet sipas notës mesatare nga viti shkollor paraprak;
- Të ketë sjellje shembullore;
- Të pranojë dhe respektojë rregulloren e “Flutura Academy” për nxënësit;

- T'i referohet thirrjes publike (referuar konkursit të shpallur për regjistrimin e nxënësve nga Flutura Academy).

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Certifikata e notave (dëftesa kopje nga viti shkollor paraprak, apo librezë e notave kopje - përfshirë pjesët që përmbajnë të dhënat identifikuese të nxënësit dhe notat e vitit paraprak shkollor)
- Certifikata e lindjes (Ekstrakti i lindjes, mund të nxirret online)

Afati për aplikim është dy javë.

Të gjithë të interesuarit për më shumë informata le të lajmërohen në Qendrën e Flutura Academy në Shtime (adresa: rruga "Tahir Sinani", ngjitur me objektin e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime), ku do të gjeni informacione të plota mbi programet e ofruara.